



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 2110/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “Ex Fis” SH.P.K., me numër të biznesit 70272163 dhe seli në Lipjan, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N.T., avokat nga Lipjani, kundër debitorit N.P “Alkobeton” me numër unik identifikues 810949901 dhe seli Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.I., avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 637/22, i lejuar me datë 25.07.2022, nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 27.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit N.P “Alkobeton” me numër unik identifikues 810949901 dhe seli Prishtinë, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr. 637/22, i lejuar me datë 25.07.2022, nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, për pjesën detyrimit në lartësi prej EUR 13,060.00 (me shkronja: trembëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë Euro).
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit N.P “Alkobeton” me numër unik identifikues 810949901 dhe seli Prishtinë, ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 637/22, i lejuar me datë 25.07.2022, nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, për borxhin në lartësi prej EUR 6,758.98 (me shkronja: gjashtëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë Euro e nëntëdhjetë e tetë Cent), MBETET NË FUQI.
- III. Shpenzimet e procedurës përbarimore i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 062-021-000272/22, e datës 02.06.2022; Faturës nr. 079-021-000030/22, e datës 18.01.2022; Faturës nr. 055-021-000002/21, e datës 04.01.2021; Faturës nr. 062-021-000421/20, e datës 13.10.2020; Faturës nr. 062-021-000089/20, e datës 11.04.2020;

Faturës nr. 055-021-000110/20, e datës 21.03.2020; Faturës nr. 062-021-000060/20, e datës 14.03.2020; Faturës nr. 055-021-000355/19, e datës 16.12.2019, si dhe; Faturës nr. 055-021-000037/19, e datës 20.02.2019, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 637/2022, të datës 25.07.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj borxhin sipas faturave në lartësi prej EUR 19,818.98, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim në shumë prej EUR 156.00.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimore pjesërisht si të paligjshëm dhe të paqëndrueshëm në prova dhe fakte. Ndërsa, ka shtuar se sipas marrëveshjes nga të dy palët, kreditori ka qenë i obliguar që të furnizoj debitorin deri në shumën prej EUR 30,000.00, dhe pastaj të bëhet barazimi ndërmjet tyre, mirëpo që kreditori në kohë të papërshtatshme ka kërkuar përmbushjen e detyrimit. Po ashtu, ka theksuar se faturat e lëshuara nga ana e kreditorit, pjesa më e madhe e tyre nuk janë të pranuar nga ana e debitorit, të njëjtat janë të pa vulosura dhe nuk janë nënshkruar nga debitori, andaj gjykata faturave të pa nënshkruara dhe të pa vulosura nuk duhet t'i falë besimin si dokument i besueshëm për përmbarim. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, urdhri përmbarimor të shfuqizohet, ndërsa të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimin në lartësi prej EUR 156.00.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimi për përmbarim ndaj debitorit është paraqitur mbi bazën e dokumenteve të besueshme të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet në kuptim të nenit 29 të LPP-së. Më tej, ka shtuar se pretendimet e debitorit se i njëjti nuk ka pranuar pjesën më të madhe të faturave nuk qëndrojnë, pasi që nga provat e prezantuara pranuesi i mallit i ka pranuar derivatet si në faturë dhe ka nënshkruar faturat, ndërsa të njetjat fatura janë regjistruara në librat e shitjes së kreditorit dhe janë deklaruar në administratën tatimore. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk gjen mbështetje në nenin 71 të LPP-së, prandaj gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi, ndërsa të obligohet debitori që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore si propozimin në shumë prej EUR 235.00, si dhe për përgjigjen në prapësim në shumë prej EUR 157.00.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat

e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Në mbështetje të dispozitave të cekura si më lartë, gjykata vendosi si në pikën I të këtij Aktvendimi duke anuluar pjesërisht urdhri përbarimor për borxhin në lartësi prej EUR 13,060.00, dhe atë sipas faturave nr. 062-021-000272/22, e datës 02.06.2022, nr. 062-021-000421/20, e datës 13.10.2020, nr. 062-021-000089/20, e datës 11.04.2020, dhe nr. 055-021-000037-19, e datës 20.02.2019, për arsye se faturat në fjalë nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme, ngase kreditori nuk ka dëshmuar se të njëjtat fatura i janë dorëzuar debitorit, dhe se debitori të njëjtat i ka pranuar dhe është njoftuar për detyrimin që buron nga to. Andaj, faturat si të tilla rezultojnë të jenë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit, të njëjtat meqë nuk ka dëshmi se janë pranuar nga debitori nuk janë bërë të arritshme për pagesë, dhe rrjedhimisht janë të papërshtatshme për përbarim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke lënë në fuqi urdhrin përbarimor për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 6,758.98, ngase dokumentet, përkatësisht fatura nr. 079-021-000030/22, e datës 18.01.2022, nr. 055-021-000002/21, e datës 04.01.2021, nr. 055-021-000110/20, e datës 21.03.2020, nr. 062-021-000060/20, e datës 14.03.2020, nr. 055-021-000355/19, e datës 16.12.2019, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, gjykata gjen se faturat në fjalë i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, ngase të njëjtat janë dorëzuar në origjinale nga ana e debitorit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në mbështetje të nenit 450, lidhur me nenin 452.2 të Ligjit për procedurën kontestimore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2110/22, datë 27.11.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.